




Funded by  
the European Union



OPEN SOCIETY FOUNDATION  
FOR ALBANIA

# BE PËR ARSIMIN GJITHËPËRFSHIRËS







Funded by  
the European Union



Tampere University  
of Applied Sciences



OPEN SOCIETY FOUNDATION  
FOR ALBANIA

# BE PËR ARSIMIN GJITHËPËRFSHIRËS



## BE për Arsimin Gjithëpërfshirës

### S1 Pedagogjia moderne për mësimnxënie më të mirë

Ju do të ftoheni në një dhomë diskutimi me 4 persona.

Ndani:

- Emri, pozicioni i punës dhe organizata ime
- Çfarë më pëlqen më shumë në punën time?
- Mos harroni të jepni kohë dhe hapësirë për çdo person që të prezantohet.



#### BE-ja për Arsimin Gjithëpërfshirës

- Për 15.000 mësues shqiptarë
- Hyrje në zbatimin e kurrikulës bazuar në kompetencë duke përdorur metoda aktivizuese të mësimdhënies dhe duke nxitur përfshirjen përmes praktikave gjithëpërfshirëse në klasë

#### BE-ja për Arsimin Gjithëpërfshirës

- **Vlerësim autentik:** të provuarit e ideve dhe raportimi i rezultateve (pa teste)
- **6 sesione 1,5-orëshe**
  - S1, S2, S3 – pedagogjia moderne
  - S4, S5, S6 – praktika të gjithëpërfshirjes
- **9 orë studimi të pavarur**
  - Detyra mësimore
  - Paketa mësimore për lëndë specifike:



#### BE-ja për Arsimin Gjithëpërfshirës

- S1 Pedagogjia moderne për mësimnxënie më të mirë
- S2 Nxënësi aktiv
- S3 Kompetencat e mësimdhënies
- S4 Mësimdhënia gjithëpërfshirëse 1
- S5 Mësimdhënia gjithëpërfshirëse 2
- S6 Mësimdhënia gjithëpërfshirëse 3

#### Paketat mësimore për lëndë specifike

- (Udhëzimet për këtë do të vijnë më pas ...)

### Metodat e punës të trajnimit

- “nxënësit mësojnë më mirë kur kanë mundësinë për t’i përjetuar gjërat vetë” -> kur i provojnë gjërat vetë
- pedagogji me pjesëmarrje, metoda aktivizuese
- puna me shokët dhe në grup
- angazhimi

### Votimi fizik

#### 1. Si mësoni më mirë?

- duke dëgjuar
- duke lexuar
- duke diskutuar
- duke vepruar

#### 2. Mund të përqendrohem duke dëgjuar për:

- 10 minuta
- 20 minuta
- 1 orë
- 2 orë

#### 3. Aftësia ime për t’u përqendruar është:

- Më e mirë se më parë (kur isha më i/e vogël)
- Afërsisht e njëjtë
- Është përkeqësuar

### Diskutim

- Cilat do të ishin përgjigjet e nxënësve tuaj për këto pyetje?
- A e marrim parasysh në mësimdhënien tonë se si mësojnë më mirë nxënësit?

### Këndvështrimi socio- konstruktive i të nxënit

**Koncepti modern i të nxënit bazuar te kërkimi shkencor.**

**Të nxënit perceptohet si një proces aktiv, dhe jo pasiv, nëpërmjet të cilit nxënësi merr njohuri.**

**Njohuria zhvillohet dhe strukturohet në kontekstet sociale të të nxënit.**

**Për të nxënë gjëra të reja, janë të rëndësishme njohuritë e mëparshme, të kuptuarit dhe përvoja.**

### Çfarë e nxit të mësuarit, sipas shkencës?

- Atmosfera e sigurisë
  - Orientimi i njohurive paraprake
  - Vetë aktiviteti i nxënësit
  - Bashkëpunimi: të nxënit bashkë me të tjerët dhe prej tyre
  - Reflektimi
  - Aktiviteti fizik
- -> Çfarë nga këto mund të rrisim në mësimdhënien tonë?



## 1. Dobitë e qasjes socio-konstruktive

- Prodhon rezultate të shkëlqyeshme mësimnxëniesje
- Nxit përvetësimin e aftësive të dobishme për jetën, p.sh.: vetëdisiplinën, pavarësinë dhe këmbënguljen
- Forcon aftësitë për të nxënit më të thellë, p.sh.: *arsyetimin analitik, zgjidhjen e problemeve të ndërlikuara dhe punën në grup.*
- Rrit mirëqenien e studentëve duke promovuar aktivitetin, pjesëmarrjen dhe angazhimin e tyre.

## Ushtrime për të krijuar grupe të vogla

1. Merrni pjesë prej dy ditësh në një trajnim që ka nevojë për aktivitetin e vetë të nxënit. Si ju duket trajnimi? **Si ndikon në të nxënit tuaj?** Gjithsecili mendon vetë para së gjithash. Nuk diskutohet. (1 min)
2. Diskutojini idetë tuaja në dyshe: **Çfarë ngjashmëri dhe dallimesh keni vënë re?** (4 min)
3. Bashkojuni një dysheje tjetër. Mos ia tregoni dyshes tjetër mendimet tuaja fillestare, por vetëm ngjashmëritë dhe dallimet e vërejtura. **Si mund të aktivizohen nxënësit gjatë një ore mësimore?** Jepuni tri ndihma të tjerëve. (10 min)
4. Çdo grup ndan një ide të mundshme për ta provuar me nxënësit.

## Metoda e krijimit të grupeve të vogla: vetëm - në dyshe - në grupe nga 4

- metodë e dobishme për ndarje informacioni dhe përvojash, për përpunimin e informacionit dhe për të krijuar bashkërisht ide dhe perceptime të reja
- zhvillon aftësitë e nxënësve për të vënë re ngjashmëritë dhe dallimet midis mendimeve dhe përvojave
- mund të përdoret edhe për *orientimin e njohurive paraprake ose për reflektim*
- i lejon nxënësit t'i mësojnë gjëra të reja njëri-tjetrit
- është veçanërisht e përshtatshme për nxënësit e ndrojtur, të urtë e që nuk flasin shumë, ose për nxënësit që iu nevojitet kohë për t'i përpunuar idetë.

BE për Arsimin Gjithëpërfshirës

## Nxënësit aktivë S2

Jam shumë i mirë në ...

Gjesha më e mirë në punën time ...

Emri im ...

Nëse nuk do të isha mësues do të isha ...

Pritshmëritë e mia për këtë trajnim

## Programi i këtij sesi

- Ushtrim me etiketa emrash (në grupime)
- Organizator i përparuar (hartëzimi i njohurive të mëparshme)
- Roli aktiv i nxënësit
- Rrathët brenda-jashtë (aktivizim)
- Vijat (reflektim)

## Organizator i përparuar

- Pse është e rëndësishme që nxënësit të jenë aktiv vetë?

Si mund të aktivizojë nxënësit një mësues? Shkruani idetë tuaja si grup. (10 minuta)

- Çdo grup ndan një pikë me të tjerët.



## Përse nuk është i mjaftueshëm transmetimi i informacioneve?

- Ajo që shpjegon mësuesi ≠ ajo që nxënë studentët
- Nuk është e mundur që të gjitha informacionet të “instalohen” te nxënësit
- E vetmja mënyrë për të nxënë, është duke i **përpunuar informacionet në mënyrë aktive.**



## Mësimdhënia e drejtuar nga mësuesi

- Një person flet, një person përgjigjet (me radhë)
- Pak persona nxënë?
- (A nxë mësuesi?)

## Metodat me pjesëmarrje

- Të gjithë ndërveprojnë
- Të gjithë nxënë?

## Çfarë mësojnë nxënësit vetëm gjatë mësimdhënies së drejtuar nga mësuesi?

- Në rastin më të mirë: marrin dije? (kjo kërkon aktivizimin mendor)
- Zbatimi i njohurive është i kufizuar
- Jini të heshtur, qëndroni të qetë dhe vigjilentë
- Aftësitë e së ardhmes nuk praktikohen dhe mësohen

## Aktivizimi i nxënësve

1. Aktivizimi i të menduarit
  - të mos jepen përgjigje të thjeshta, të mos përsëriten fakte
  - të përfshihen nxënësit në diskutime dhe reflektime
  - t'u kërkohet nxënësve të bëjnë pyetjet dhe japin teoritë e tyre
  - Bëni pyetje të hapura
2. Nxënësit *marrin pjesë* në mënyrë aktive
  - duke përdorur metodat pjesëmarrëse që kërkojnë aktivizimin e vetë nxënësve
  - duke vepruar, testuar, bashkëpunuar, etj.

### Aktivizimi i metodave mësimdhënëse - çfarë?

- Promovimi i aktivitetit vetjak të nxënësve gjatë të nxënësve
- Nxënësit si agjentë aktivë, në vend të dëgjuesve pasivë
- Bazuar te pikëpamja socio-konstruktiviste për të nxënësve



### Aktivizimi i metodave mësimdhënëse - çfarë?

- **Të menduarit aktivizues;** pyetje, argumente, i menduari provokues
- **Metodat me bazë aktivitetin**
  - Mësojmë duke vepruar
  - Metodat me veprime eksperimente
  - Metodat bashkëpunuese
  - Metodat krijuese, teatër



## Rrathët e brendshëm-të jashtëm

1. Çfarë mendimesh nxiti prezantimi?
2. Jepni idenë/këshillën tuaj më të mirë, se si mund të rritet ndërveprimi në klasën tuaj!
3. A mund ta përdorni këtë metodë (rrethet brenda-jashtë) në mësimdhënien tuaj? Si? Ndani idetë me grupin tuaj. (max 5 min)

### Metoda e rrathëve të brendshëm-të jashtëm

- metodë bashkëpunuese që rrit ndërveprimin e përgjithshëm të grupit
- mundëson ndarjen e njohurive, përvojave dhe mendimeve, si dhe të nxënësve nga të tjerët.

#### Mund të përdoret për:

- matjen e nocioneve dhe njohurive të mëparshme: Për çfarë keni njohuri? Si do ta përshkruanit...?
- ndarjen e njohurive, mendimeve dhe përvojave: Çfarë keni mësuar sot? Si ndiheni për? Çfarë përvojash keni?
- rishikimin dhe testimin e koncepteve të njohura: Çfarë mbani mend? Pyesni personin përballë jush.

### Përfitimet e metodës së rrathëve të brendshëm-të jashtëm

- rrit kohën e ndërveprimit të njëkohshëm në klasë
- nxit nxënës të vijnë për qark vendit, që të qëndrojnë ulur në bankat e tyre
- çdo nxënës merr vëmendje
- koha e pjesëmarrjes aktive në klasë e secilit nxënës, barazohet: të gjithë kanë të drejta dhe mundësi të barabarta për pjesëmarrje
- u jep nxënësve të urtë dhe të ndrojtur mundësinë për të marrë pjesë në mënyrë të qetë
- rrit aftësitë komunikuese dhe ndërvepruese të nxënësve
- shton atmosferën pozitive në klasë: shpesh çon në diskutime pozitive dhe të lirshme

### Vijat

PO apo JO?

- Mora ide të reja nga pjesëmarrësit e tjerë sot.
- Mendoj se isha mjaft pasiv në seancën e sotme.
- Pas këtij sesi, jam kureshtar të mësoj më shumë.

### Metoda Vijat

Kjo metodë mund të përdoret për të bërë të dukshme pikëpamje dhe mendime të ndryshme në klasë dhe për të rritur tolerancën ndaj diversitetit.

Kjo metodë mund të përdoret gjithashtu për:

- 1) Ngrohje (deklarata argëtuese për gjëra të rastësishme)
- 2) Orientim (deklarata për njohuritë paraprake të nxënësve mbi lëndën) ose
- 3) Reflektim (cilat janë mendimet e nxënësve për ato që janë mësuar dhe si janë mësuar)

BE për Arsimin Gjithëpërfshirës

## Kompetencat e mësimdhënies S3


**Kompetencat në kurrikulën shqiptare.**

Kompetencat janë njohuri, aftësi, vlera, sjellje



## Festa e kompetencave

- Në karta keni emrin e kompetencës dhe një përshkrim të shkurtër të tipareve të saj. Mos ua tregoni të tjerëve.
- Lëvizni vërdallë dhe filloni të flisni me të tjerët. Përshkruajeni veten sipas tipareve të kësaj kompetence. Bëni pyetje që të zbuloni emrin e kompetencave të të tjerëve.
- Flisni me persona të rinj.



## Metoda e lojës me role

- Nxënësit përpunojnë në mënyrë aktive dhe zhvillojnë këndvështrime të ndryshme në lidhje me emën.
- Loja me role krijon ndjenjën e sigurisë, pasi mendimet e nxënësve janë ato të karakterit që përfaqësojnë, jo të tyre.
- Secilit nxënës i caktohet një rol. Rolet mund të lidhen me temën e mësimin (për shembull, gjatë trajtimit të bullizmit, rolet mund të jenë ai i personit të bullizuar dhe bullizuesit, personat që vëzhgojnë, mësuesi, drejtori i shkollës, etj.) ose mund të jenë rastësore (p.sh., profesione të ndryshme). Mësuesit mund të përdorin imagjinatën dhe të krijojnë role për lëndët e tyre: rolet mund të jenë figura historike, bimë, qytete ose vende etj.

## Metoda e lojës me role

- Nëpërmjet rolit, nxënësit duhet të përcjellin mendimet dhe qëndrimet e tyre rreth temës:
- të gjithë mund të shprehin se si e shohin situatën ose temën nga pikëpamja e rolit të tyre.
- nxënësit e tjerë mund t'u drejtojnë pyetje lidhur me situatën ose temën.
- Synimi është të kuptuarit e aspekteve dhe këndvështrimeve të ndryshme rreth temës.
- Nxënësit edhe mund t'i ndryshojnë rolet për të kuptuar më mirë duke e parë situatën nga një këndvështrim tjetër.
- Pas ushtrimit, është mirë të diskutohen pikëpamjet që nxënësit fituan gjatë lojës me role duke kryer dhe vëzhguar role të ndryshme.



## Mësimi i kompetencave – çfarë janë kompetencat?

- Çfarë janë kompetencat?
  - Njohuri, aftësi, qëndrime dhe vlera
  - Kompetenca është aftësia për të aplikuar ose përdorur një grup njohurish, aftësish dhe zotësish që lidhen me njëra-tjetrën.”



## Mësimi i kompetencave

- Mësimi i kompetencave kërkon që nxënësit
  - të mund të provojnë gjëra vetë
  - të marrin pjesë në mënyrë aktive në të nxënin e tyre
  - të praktikojnë aftësitë që duhet të nxënë
- Mësimi i kompetencave është shumë i kufizuar nëse mësimdhënia është vetëm e drejtuar nga mësuesi.

## Mësimi i kompetencave

“Kurrikula e bazuar te kompetenca është kurrikula që thekson më shumë atë që duhet **të bëjnë** nxënësit” në vend që të përqendrohet kryesisht tek ajo që duhet **të dinë**.

Parimisht, një kurrikul e tillë është e përqendruar te nxënësi dhe u përshtatet nevojave në ndryshim e sipër të nxënësve, mësuesve dhe shoqërisë.”

## Çfarë nxënë nxënësit gjatë mësimdhënies së drejtuar vetëm nga mësuesi?

- Në rastin më të mirë: njohuri? (ka nevojë për aktivizim mendor)
  - Njohuria e aplikuar është e kufizuar
- Mos fol, mos lëviz dhe mos fli gjumë
  - Nuk përfitohen aftësi për të ardhmen




## Roli i mësuesve në socio-konstruktivizëm

- Mësuesit duhet të zhvendosen nga pozicioni i “atyre që japin mësim” tek të qenët “lehtësues të të nxënit”
- Roli i mësuesit është të mbështesë dhe ushqejë procesin e të nxënit: mësuesit janë lehtësues që mundësojnë zhvillimin dhe të nxënit e nxënësve

## Si mund të zbatohet këndvështrimi socio- konstruktivist i të nxënit?

- Bëni pyetje të hapura
- Kërkojuni nxënësve të shpjegojnë përgjigjet e tyre
- Kërkoni shpjegime për fjalët ose ekuacionet që përdorin
- Lëri nxënësit të krijojnë pyetjet dhe teoritë e tyre dhe më pas t’i testojnë ato.
- Pranojini gabimet që vijnë nga idetë e nxënësve; ato shërbejnë si mundësi të rëndësishme për të nxënë



- Sfidojini nxënësit tuaj duke u kërkuar të kryejnë hulumtime të hapura, të punojnë për zgjidhjen e problemeve me kontekste realiste/nga përditshmëria
- Lejojini nxënësit të eksplorojnë dhe të zhvillojnë gjetje dhe shpjegime mbështetëse ose kundërshtuese
- Diskutoni, shqyrtoni dhe sqaroni mospërputhjet me nxënësit tuaj
- **Zhvillimi i shprehive të të menduarit, të nxënësve si të nxënësve.**

### Si mund të zbatohet këndvështrimi socio- konstruktivist i të nxënësve?

- Përdorni metoda të larmishme, aktivizuese dhe bashkëpunuese për mësimdhënien
- Nxënësit ndërveprimin dhe bashkëpunimin ndërmjet nxënësve
- Promovoni veprimtarinë vetjake të nxënësve
- Kushtojini vëmendje orientimit dhe hartëzimit të njohurive ekzistuese të nxënësve
- Inkurajojini nxënësit tuaj të reflektojnë në lidhje me të nxënësve e tyre

### Pse të përdorim metoda elastike mësimdhënëse?

- Nxisin të nxënësve
- Nxënësit janë të ndryshëm dhe e ndiejnë gëzimin e të nxënësve dhe suksesin në mënyra të ndryshme.
- Përdorimi i metodave mësimdhënëse elastike promovon gjithëpërfshirjen dhe kohezionin social.
- **Nxisin aftësi të ndryshme kur përdorni metoda të ndryshme.**
- Cilat janë aftësitë kryesore dhe kompetencat e së ardhmes?



### Metoda elastike për nxënës të ndryshëm

- Mësimdhënia e drejtuar nga mësuesi
- Studime të pavarura
- Metoda aktivizuese
- Të nxënësve bashkëpunues
- Të nxënësve e bazuar te projekti
- Të nxënësve e bazuar te kërkimi dhe fenomeni
- Përdorimi i aplikacioneve dhe mjediseve digjitale të të nxënësve
- Të nxënësve nëpërmjet lojës, të bërit të gjërave, duke mësuar, etj. etj.

## Ushtrime në grupe

- Shkruajini kompetencat tuaja në letër, por jo emrin tuaj!
- Shkruani në letër se si jepni mësim/do të dëshironit të jepnit mësim në lëndën/klasën tuaj (metoda, ide, etj.) Mund të parashtroni edhe vështirësitë tuaja lidhur me mësimdhënien e kësaj kompetence.



### Le te zmadhohet ideja

- Kalojani letrën tuaj kolegut ngjitur.
- Edhe juve do t'ju kalojnë një fletë tjetër letre. Lexojeni plotësisht, shtoni, komentoni, kritikoni, lavdëroni...




### Metoda ortek

Emri i metodës, “orteku”, përshkruan efektin ortek të mbledhjes së njohurive: ai nis me një ide, e cila krijon këndvështrime të reja, nëpërmjet së cilave njohuritë rreth lëndës zgjerohen sikurse zmadhohet orteku kur rrokulliset përgjatë një kodre me dëborë.

Vini re! Nuk është e nevojshme që nxënësit t'i shkruajnë emrat e tyre në fletë; nuk ka rëndësi se kush e shkroi idenë, rëndësi ka që nxënësit të fitojnë këndvështrime të reja duke lexuar shënimet e të tjerëve.

### Metoda ortek

- mund të përdoret për
- të zhvilluar ide të reja
- hartëzimin e të kuptuarit faktik të temës nga nxënësit
- përpunimin e informacioneve të reja
- ushtrime zhvillimi.



### Lart apo poshtë?



### Metoda lart apo poshtë

- Metodë shumë e dobishme për të njohur ndjenjat e nxënësve përpara nisjes së një teme të re ose për të reflektuar pas studimit të një teme.
- Aktiviteti fizik promovon të nxënin.



## Detyra për Sesionet e Mësimit Aktiv dhe Bashkëpunues

Provoni ndonjë nga metodat e prezantuara gjatë këtyre sesioneve me nxënësit tuaj. Dërgoni një raport tek trajneri juaj.

- Provojini disa ide ose metoda të prezantuara gjatë sesionëve S1-S3 ose në paketat e mësimit të lëndëve specifike në klasën tuaj.
- Shkruani një raport për detyrën tuaj dhe dërgojeni tek trajneri:
- Cila ishte grupmosha, lënda, madhësia e grupit?
- Çfarë metodash ose praktikash të reja provuat?
- Përshkruani eksperimentin tuaj dhe si shkoi: Si e përgatitët? Si ishte detyra? Si shkoi aktiviteti? Si e morën nxënësit ushtrimin? Çfarë lloj feedback-u morët nga nxënësit për këtë?
- Bashkëngjitni një fotografi të ushtrimit në raportin tuaj.
- Çfarë do të bëni ndryshe herën tjetër? Çfarë do të dëshironit të provoni herën tjetër?

Ju lutem, dërgoni detyrën tuaj në adresën e-mail të trajnerit. Pas dorëzimit, do të merrni një feedback të shkurtër nga trajneri juaj.

## BE për Arsimin Gjithëpërfshirës

### Hyrje në arsimin gjithëpërfshirës

#### Axhenda

##### Hyrje dhe nxemje

##### Përkufizimi teorik i gjithëpërfshirjes

- Nga veçimi tek gjithëpërfshirja sociale
- Si do të zbatohet arsimit gjithëpërfshirës?

##### Intervistoni dhe prezantoni çiftin tuaj

- Intervistoni 5 minuta çiftin tuaj
  - 1. Emri
  - 2. Puna
  - 3. Një gjë për të cilën do t'ju mbajmë mend
- Ndërrohet çifti
- Prezantoheni njëri-tjetrit tek i gjithë grupi

##### Detyrë: Vështrim paraprak në shkollën finlandeze

- Video: <https://toolbox.finland.fi/themes/education-and-know-how/the-finnish-way/>
- Zgjidhni atë ide nga videoja që është më e rëndësishme për ju
- Diskutim i videos



### Përkufizimi teorik i gjithëpërfshirjes

#### Detyrë: kartat me figura

- Zgjidhni atë kartë me figura që pasqyron për ju:
- Gjithëpërfshirjen/Arsimim për të gjithë/Askush nuk lihet mbrapa
- Diskutoni me personin ngjitur për këndvështrim tuaj dhe të tij/saj se si e pasqyron/përfaqëson gjithëpërfshirjen figura
- Krahasoni mendimin tuaj me çiftin tuaj: A ishin idetë të ngjashme apo të ndryshme?
- Kërkojini çdo çifti që të përzgjedhë dhe të ndajë vetem një ide për të tjerët.



## Nga veçimi tek gjithëpërfshirja sociale

- Përpara Mesjetës reagimet ndaj personave të ndryshëm dhe me aftësi të kufizuara ishin lënia pas dore, veçimi dhe supersticioni
- Dredhia, veçimi dhe lënia pas dore ishin etiketat e të ndryshmit
- Në Mesjetë, jeta njerëzore filloi të respektohej - nuk hiqej dhe rreziku i vdekjes
- Njerëzit me aftësi të kufizuara të shqisave mëshiroheshin, ndërsa ata me zhvillim mendor të vonuar dhe të gjymtuarit ende konsideroheshin si shërbëtorë të djallit
- Për shembull, Luter dhe Kalvin e konsideronin zhvillimin mendor të vonuar si shenjë mëkati

## Arsimi i specializuar që nga shekulli i 17-të

- Mësimdhënia e zejeve për personat me aftësi të kufizuara shqisore nisi në mesin e viteve 1700 në Paris (filozofët e Iluminizmit, p.sh.: Pestaloci, Ruso)
- Njerëzit me aftësi të kufizuara të zhvillimit ende konsideroheshin si të sëmurë të pashërueshëm dhe mbaheshin në institucione të ndryshme
- Mësimdhënia për personat me zhvillim mendor të vonuar nisi në fillim të shekullit të 19-të në Paris

## Veçimi

- Organizimi i shërbimeve veçmas
- Bazuar në kriteret e diferencimit (p.sh.: diagnozat)
- Organizimi i arsimit të specializuar në njësi të veçanta (shkolla të specializuara/klasa/klasa të vogla)
- Forma më tradicionale e organizimit të mbështetjes dhe mësimdhënies së specializuar

## Normalizimi

- Koncepti e ka zanafillën në Danimarkë (1959), kur u përdor për të organizuar jetën e njerëzve me aftësi të kufizuara intelektuale sa më të afër që të ishte e mundur të ashtuqajturës mënyrë normale të jetës.
- Model i krijuar nga suedezi Bengt Nirje në vitet 1960-të, qëllimi i të cilit ishte që të krijonte një model për njerëzit me aftësi të kufizuara të zhvillimit, sipas të cilit jeta dhe rrethanat e tyre të përditshme do t'i afroheshin sa më shumë që të ishte e mundur modelit të jetesës të pjesës tjetër të shoqërisë.
- <http://www.disabilityhistorywiki.org/leadership/presentationpage.asp?presentation=6>

## Praktika e integritit

Në Shtetet e Bashkuara, ideologjia e integritit u përdor për të eliminuar veçimin.

Mjedisi sa më Pak Kufizues i të Nxënurit (LRE) dhe Programi për Zhvillimin Individual të nxënësve (IEP)



### Gjithëpërfshirja

- Në Shtetet e Bashkuara, lëvizja për Integrimin nuk ishte e mjaftueshme për kundërshtarët më të flaktë të veçimit në vitet 1980-të, lindën lëvizje të reja :
- Lëvizja REI (Nisma për Arsimin e Rregullt) (arsimi i përgjithshëm duhet të marrë përgjegjësi për të mësuar të gjithë nxënësit) dhe
- Lëvizja e arsimit gjithëpërfshirës (Lipsky, Gartner) (të gjithë fëmijët, të cilët shkojnë në një shkollë afër, marrin arsim të individualizuar sipas kërkesave të tyre)
- Arsimi gjithëpërfshirës bazohet në drejtësinë sociale, barazinë dhe demokracinë



## Gjithëpërfshirja – askush nuk lihet pas



### Konventa ndërkombëtare

**Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut - OKB, 1948**

**Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës – OKB, 1989**

(Ratifikuar nga Shqipëria në vitin 1990)


**Deklarata e Salamankës - UNESCO, 1994**

(Shqipëria ra dakord që t'i arrinte objektivat deri në vitin 2015)

**Akti për Arsimimin e Individëve me Aftësi të Kufizuara i vitit 1997.**

**Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara - OKB, 2006.**

**Strategjia Evropiane për Aftësitë e Kufizuara 2010-2020**



## MODEL I AFTËSISË SË KUFIZUAR

### Modeli klinik/mjekësor

Njerëzit me aftësi të kufizuara shihen si problem, si një dëmtim që duhet të mjekohet, që duhet të rregullohet me terapi, barna, kirurgji dhe trajtime të veçanta.

### Modeli shoqëror

Ky model përqendrohet tek pengesat në mjedis. Njerëzit i bëjnë të paaftë mjedisi, qëndrimet e të tjerëve dhe politikat, praktikatat dhe organizatat.

Idea e modelit shoqëror të aftësisë së kufizuar ka buruar nga dokumenti “Parimet themelore të aftësisë së kufizuar”, botuar për herë të parë në mesin e viteve 1970-të, në të cilin argumentohej se “neve nuk na bëjnë të paaftë dëmtimet tona, por pengesat dëmtuese me të cilat jemi përballur në shoqëri” (Oliver, 2013).

## Gjithëpërfshirja sociale

- Pengesat janë në mjedis.
- **“Neve nuk na bëjnë të paaftë dëmtimet tona, por pengesat dëmtuese me të cilat përballemi në shoqëri” (Oliver, 2013)**
- Gjithëpërfshirja është tregues i përfshirjes së individëve me nevoja të posaçme, si dhe i dallimeve sa i takon gjinisë, përkatësisë etnike, kulturës dhe klasës shoqërore (p.sh.: Ainscow et al., 2006; Forlin, 2010; Mäkinen & Mäkinen, 2011; Väyrynen & Paksuniemi, 2020).
- Njerëzit i bëjnë të paaftë mjedisi, qëndrimet e të tjerëve dhe politikat, praktikatat dhe organizatat.
- Gjithëpërfshirja është një proces që do të çojë në pjesëmarrjen e të gjithë atyre që mësojnë në programin shkollor dhe në jetën shoqërore të të gjitha strukturave ku bëhet mësim.
- Arsimi gjithëpërfshirës lidhet me të mësuarit që të bashkëjetohej me diversitetin jo si problem, që duhet të zgjidhet, por si një mundësi e jashtëzakonshme e arsimit krijues. (Zoniou-Sideri, 2000)

**Ideja e gjithë kësaj është që gjithkush të ndihmohet që të gjejë mënyrën e vet të të mësuarit**




### Si do të zbatohet arsimi gjithëpërfshirës?



Detyrë: Diskutoni me shokët tuaj të klasës për diversitetin në jetë (reale)

- Si duhet të përballemi me diversitetin në jetë?
- Si duhet të mbështeten nxënësit me nevoja të ndryshme (shoqërore, emocionale, motivuese, njohëse)?


Për një përzgjedhje të drejtë të gjithë duhet të marrin të njëjtin provim: jeni të lutur ta ngjisni atë pemë.



### Shkurt: si të bëhet diferencimi

Mësuesi duhet ta njohë nxënësin:

të dijë si mëson ai ose ajo dhe për çfarë lloj mbështetjeje ka nevojë ai ose ajo



...dhe të njohë programin shkollor: përmbajtjen thelbësore, minimumin që ka nevojë një nxënës të mësojë ose të bëjë për të kaluar kursin, dhe, më pas, të gjejë mënyrat më të mira për t'ua mësuar nxënësve këto përmbajtje.

Krijimtaria nevojitet gjithashtu për të bërë modifikimet që janë më mirë për çdo individ

## Diferencimi i arsimimit

- “Diferencimi i arsimimit është një mjet parësor për të marrë parasysh nevojat e grupit që merr mësim dhe diversitetin e nxënësve, që përshkojnë të gjithë shkollimin.
- Vëmendje i kushtohet mënyrave të të mësuarit dhe ritmeve të punës karakteristike për nxënësit e ndryshëm, aftësive dhe interesave të ndryshme, si dhe nevojave emocionale lidhur me vetëvlerësimin dhe motivimin. Merren në konsideratë diferencimet dhe formimet zhvillimore midis vajzave dhe djemve dhe midis nxënësve individualë.
- Diferencimi përdoret për të ndikuar tek motivimi për të mësuar. Diferencimi i arsimimit bën të mundur përballjen e nxënësve me sfida dhe pajisjen me përvoja të përshtatshme të suksesit dhe u ofron atyre mundësi për të zhvilluar dhe mësuar sipas pikave të tyre positive. Në këtë aspekt, është e rëndësishme që të përdoren aftësitë dhe interesat e ndryshme të nxënësve në të njëjtin grup që merr mësim.”



## Çfarë është diferencimi?

### Si duhet të diferencohet arsimimi? (1)

- “Të tre dimensionet kryesore të diferencimit lidhen me **ndryshimet në shkallën dhe thellësinë e studimeve dhe ritmit të përparimit në studime**”.
- > Mësuesi duhet ta njohë programin shkollor mjaft mirë që të jetë në gjendje të gjejë përmbajtje të përshtatshme për të studjuar për çdo nxënë.
- Disa nxënësve të grupit mund t’u duhet më shumë kohë për të mësuar konceptet bazë të një lënde të caktuar ose të fushës së përmbajtjes -> pra, atyre iu nevojiten tekste më të shkurtra, kohë për të praktikuar fjalët kryesore dhe kuptimet e tyre ose ushtrimet më elementare. Ata do të studiojnë vetëm **përmbajtjen thelbësore**.
- Disa nxënësve mund t’u nevojiten më shumë sfida dhe material shtesë për të mësuar më shumë dhe për të zbatuar atë që kanë mësuar për t’i mbajtur të motivuar që të mësojnë.

## Çfarë është diferencimi?

### Si duhet të diferencohet arsimimi? (2)

Diferencimi mund të përqendrohet gjithashtu në fusha: të tilla si:

- materialet mësimore
- detyrat e dhëna nxënësve
- metodat e aplikuara,
- sasia e detyrës së shkollës dhe detyrës së shtëpisë,
- sasia e kohës në dispozicion.

Disa nxënës kanë nevojë për materiale më konkrete me të cilat të punojnë; për të treguar konceptet ose fenomenet dhe për t’i provuar gjërat në praktikë.

- > **të gjitha këto gjëra lidhen me njohuritë e mësuesit lidhur me kërkesat e programit shkollor dhe të kuptuarit e përmbajtjes thelbësore!**

## Çfarë është diferencimi?

### Si duhet të diferencohet arsimimi? (3)

Mjedisi në të cilin merret mësim dhe qasjet e punës mund të modifikohen:

- duke krijuar mundësi pjesëmarrjeje për nxënësit, duke ofruar zgjedhje,
- **duke përshtatur përdorimin e hapësirës;** shembuj: rregullime që e lejojnë nxënësin të lëvizë nëpër dhomë ndërsa bën detyrat e shkollës, karriget që lejojnë lëvizje, mundësi për të zgjedhur një vend pune të qetë ose një hapësirë që lejon shkëmbimin e mendimeve gjatë punës
- **duke i grupuar nxënësit në mënyrë fleksibël;** p.sh.: bazur në nivelin aktual të aftësive të nxënësve. Grupet nuk duhet të jenë të pandryshueshme dhe të përhershëm dhe të gjitha mësimet e një lënde të caktuar nuk duhet të bëhen në këto grupe, por në njëfarë shkalle duke punuar në të njëjtën nivel aftësish me të tjerët në grup sjell dobi për mësimnxënien. Kërkon punë në ekip nga ana e mësuesve! (Ekzistojnë edhe disa mënyra të tjera për grupimin e nxënësve në mënyrë fleksibël, shih diapozitivë të tjerë në fund të këtij leksioni)
- duke shfrytëzuar situatat për të mësuar jashtë shkolle.
- Interesat e nxënësve merren në konsideratë në arsimim duke lidhur njohuritë dhe aftësitë, që përftohen, me përvojat dhe veprimtaritë, të cilat atyre mund t'u duken të rëndësishme.
- Nxënësit mund të kenë nevojë për mundësi të ndryshme për të treguar njohuritë, aftësitë dhe përparimin e tyre dhe ata gjithmonë përfitojnë nga opinionet vlerësuese individuale.

## Udhëzimi dhe këshillimi

“Përveç arsimimit, çdo nxënës ka të drejtën që të marrë udhëzim dhe këshillim. Qëllimi i veprimtarive të udhëzimit dhe këshillimit është që të mbështetet suksesi i nxënësve në faza të ndryshme të arsimit bazë, me qëllim forcimin e aftësive për të mësuar dhe të vetëdrejtimit.”

“Është detyra e çdo mësuesi që t'i drejtojë nxënësit në shkollim dhe studimin e lëndëve të ndryshme, duke parandaluar kështu lindjen e problemeve lidhur me studimin.”

“Udhëzimi dhe këshillimi konsolidojnë gjithashtu aftësitë e nxënësve për bashkëpunim dhe zotësinë e tyre për të funksionuar në grupe të ndryshme dhe të marrin përgjegjësi për punën e vet dhe për punën e tyre të përbashkët. Udhëzimi dhe këshillimi kontribuojnë në parandalimin e përjashtimit të nxënësve dhe në nxitjen e barazisë.”

“Është gjithashtu detyra e çdo mësuesi që të mbështesë rritjen, zhvillimin dhe përfshirjen personale të nxënësve. Udhëzimi dhe këshillimi lidhen me të gjitha situatat e mësimdhënies, lëndët dhe opinionet vlerësuese që jepen për nxënësit. Opinionet e ndryshme vlerësuese duhet të shfrytëzohen në mënyrë sistematike për inkurajimin dhe udhëzimin e nxënësve.”

## Mësimdhënia përmirësuese

- “Një nxënës, që ka mbetur mbrapa përkohësisht ose që, nga ana tjetër, ka nevojë për mbështetje në një periudhë afatshkurtër për të bërë mësimet, ka të drejtën që t'i jepet mësim me qëllim përmirësimin. Mësimdhënia përmirësuese duhet të fillojë menjëherë pas konstatimit të vështirësive në të mësuar me qëllim që nxënësi të mos mbetet mbrapa në mësimet në mënyrë të përhershme.”
- Mësimdhënia përmirësuese, shpeshherë, praktikohet në një grup të vogël, nganjëherë në mënyrë individuale.
- Mësimdhënia përmirësuese, shpeshherë, praktikohet në formën e disa orëve mësimi shtesë pas ose përpara ditës së zakonshme të shkollës të nxënësve.
  - Nganjëherë nuk ka rëndësi që të shtohen orë të tjera mësimi në ditën e shkollës të nxënësve, pasi ata mund të jenë të lodhur nga mësimet e tyre të zakonshme. Në këto raste, mund të jetë e dobishme që të bëhen zgjidhje grupimi fleksibël gjatë orëve të mësimimit me qëllim rregullohet mësimdhënia përmirësuese.

- Mësimi duhet të planifikohet në mënyrë që të sigurohet që çdo nxënës të ketë mundësi që të marrë pjesë në mësimdhënien përmirësuese kur lind nevoja.
- Mësimdhënia përmirësuese karakterizohet nga detyrat e individualizuara, përdorimi i individualizuar i kohës dhe udhëzimi dhe këshillimi. Mësimdhënia përmirësuese duhet të ofrohet duke shfrytëzuar metoda dhe materiale të ndryshme, të cilat bëjnë të mundur identifikimin e mënyrave të reja të qasjes ndaj temës që mësohet.

### Arsimi i specializuar me orar të pjesshëm

- Arsimi i specializuar është në dispozicion të të gjithë nxënësve në Finlandë në formën e arsimit të specializuar me orar të pjesshëm.
- Mësuesit, të cilët trajtojnë nevojat e veçanta dhe ofrojnë arsim të specializuar me orar të pjesshëm, punojnë me klasa të rregullta, në bashkëpunim me mësuesit e klasave dhe mësuesit e lëndëve.
- Nuk është e nevojshme që një nxënës të klasifikohet si "i përshtatshëm për arsim të specializuar" apo që të ketë ndonjë lloj diagnoze për ta marrë këtë shërbim.
- Mësuesit vlerësojnë nevojat për mbështetje që kanë nxënësit dhe vendosin kush do të marrin arsim të specializuar me orar të pjesshëm.
- Forma fleksibël e mbështetjes: nxënësit mund të marrin arsim të specializuar me orar të pjesshëm për periudha të ndryshme kohe, një herë ose disa herë në javë, në një ose më shumë lëndë.
- Mësuesit, të cilët trajtojnë nevojat e posaçme, japin mësim në grupe të vogla, mësim individual dhe japin mësim, gjithashtu, bashkë me mësuesit e integrit.

### Bashkëmësimdhënia

- Ekzistojnë disa forma të mësimdhënies bashkëpunuese. Disa forma kërkojnë planifikim më të paktë bashkërisht, disa prej tyre kërkojnë gjithashtu bashkëplanifikim të plotë të mësimëve :


**"Njëri jep mësim – njëri vëzhgon"**

**"Njëri jep mësim - njëri asiston"**

**Grupime fleksibël**

**Mësimdhënia me rotacion**

**Mësimdhënie për të gjithë klasën si grup**



Nevoja për  
planifikim  
kohor të  
përbashkët  
rritet

## BASHKËMËSIMDHËNIA

Walther-Thomas dhe kolegët (2000)




Figura 1. Qasjet ndaj bashkëmësimdhënies. Nga M. Friend & W. D. Bursuck, 2009, "Përfshirja e nxënësve me nevoja të posaçme: udhëzues praktik për mësuesit që japin mësim në klasa të veçanta" (botimi i 5-të, f. 92). Columbus, OH: Merrill.

### Detyrë e mësimnxënies të S4

- Shkruani një raport të detyrës suaj të mësimnxënies dhe dërgojani trajnerit:
  - Bëni një përshkrim dhe jepni arsyt bazuar në leksionin lidhur me hyrjen në arsimin gjithëpërfshirës :
    - Cilat ide të gjithëpërfshirjes do të zbatoni?
    - Cilat ide të gjithëpërfshirjes nuk do të zbatoni?
    - Ç'lloj pyetjesh kritike keni për arsimin gjithëpërfshirës?

## Bibliografia

- Ainscow, M. (2020). "Nxitja e gjithëpërfshirjes dhe barazisë në arsim: mësim nga përvojat ndërkombëtare". *Nordic Journal of Studies in Educational Policy*, 6 (1), 7–16. <https://doi.org/10.1080/20020317.2020.1729587>
- Engelbrecht, P., Savolainen, H., Nel, M., Koskela, T., & Okkolin, A-M. (2017). "Dhënia kuptim arsimit gjithëpërfshirës: praktikat në klasë në klasat finlandeze dhe afrikanogjore". *Krahaso: A Journal of Comparative and International Education*, 47 (5), 684–702. <https://doi.org/10.1080/03057925.2016.1266927>
- Kaukko, M., Wilkinson, J., & Kohli, R. K. (2021): "Dashuria pedagogjike në Finlandë dhe Australi: studim i fëmijëve refugjatë dhe mësuesve të tyre", *Pedagogy, Culture & Society*. <https://doi.org/10.1080/14681366.2020.1868555>
- Kiuppis, F. (2014). "Pse (nuk duhet) të bashkohet parimi i përfshirjes me aftësinë e kufizuar? Gjurmimi i lidhjeve nga fillimi i 'Procesit Salamanca'". *International Journal of Inclusive Education*, 18 (7), 746–761. <https://doi.org/10.1080/13603116.2013.826289>
- Kuusisto, E., Laine, S., & Rissanen, I. (2021). "Arsimimi i personave me dhunti dhe të talentuar në Finlandë". Tek E. Kuusisto, M. Ubani, P. Nokelainen, & A. Toom (redaktorë), "Mësuesit e mirë për shkollat e të nesërme - qëllimi, vlerat dhe talentet në arsim" (f. 195–216). Brill-Sense. [https://doi.org/10.1163/9789004465008\\_011](https://doi.org/10.1163/9789004465008_011) E-Book, Biblioteka "Tuni": <https://ebookcentral.proquest.com/lib/tampere/detail.action?docID=6631761>
- Laine, S. (2016). "Këndvështrimet e mësuesve të shkollave fillore finlandeze për arsimin e personave me dhunti" ëDizertacion i doktoraturës, Universiteti i Helsinkit]. Helda. <http://urn.fi/URN:ISBN:978-951-51-2503-3>
- Lakkala, S., Uusiautti, S., & Määttä, K. (2016). "Si duhet të bëhet shkolla e lagjes shkollë për të gjithë?" *Journal of Research in Special Educational Needs*, 16 (1), 46–56. <https://doi.org/10.1111/1471-3802.12055>
- Mäkinen, M. (2013). "Angazhimi në praktikat gjithëpërfshirëse: refleksione narrative për mësimdhënien si përshkrues të angazhimit në punë të mësuesve". *Teaching and Teacher Education*, 35, 51–61. <https://doi.org/10.1016/j.tate.2013.05.005>
- Tirri, K., & Laine, S. (2017). "Sfidat etike në arsimin gjithëpërfshirës: rasti i nxënësve me dhunti". Tek A. Gajewski (botues), "Etika, paanësia dhe këndvështrimet ndërkombëtare për arsimin gjithëpërfshirës", 9, 239–257. *Emerald Group Publishing Limited*. Vainikainen, M-P., Thuneberg, H., Greiff, S., & Hautamäki, J. (2015). " Bashkëpunimi multiprofesional në shkollat finlandeze". *International Journal of Educational Research*, 72, 137–148. <https://doi.org/10.1016/j.ijer.2015.06.007>
- Vetoniemi, J., & Kärnä, E. (2019). "Të qenurit i përfshirë – përvoja të pjesëmarrjes sociale të nxënësve me nevoja të arsimit të specializuar në shkollat e zakonshme të arsimit publik". *International Journal of Inclusive Education*. <https://doi.org/10.1080/13603116.2019.1603329>
- Holopainen, L., Kiuru, N., Mäkihonko, M. & Lerkkanen, M.-L. 2017. "Roli i arsimit të specializuar me kohë të pjeseshme në mbështetje të nxënësve me vështirësi për të lexuar dhe gërmëzuar nga klasa 1 deri në klasën 2 në Finlandë". *European Journal of Special Needs Education*. doi/abs/10.1080/08856257.2017.1312798
- Hofmann, C., Koch, A., Bauer, K., Holopainen, L., Mäkihonko, M., Hakkarainen, A., Baur, S. & Kofler, D. 2016. "Refleksione mbi rëndësinë e njohurive, kuadri i punës kërkimore, roli i mësuesve dhe filozofia gjithëpërfshirëse e promovuar në Itali, Gjermani dhe Finlandë». 311- 322. In <http://ojs.francoangeli.it/omp/index.php/oa/catalog/download/199/28/864-1>
- Malinen, Olli-Pekka (2013) "Arsimi gjithëpërfshirës nga këndvështrimi i mësuesve: shqyrtimi i vetë-eftkësitetit dhe qëndrimeve të mësuesve para dhe në shërbim në Kinën Kontinentale". [http://epublications.uef.fi/pub/urn\\_isbn\\_978-952-61-1167-4/urn\\_isbn\\_978-952-61-1167-4.pdf](http://epublications.uef.fi/pub/urn_isbn_978-952-61-1167-4/urn_isbn_978-952-61-1167-4.pdf)

BE për Arsimin Gjithëpërfshirës

## Vështirësitë në të nxënë


### Rendi i ditës

- Prezantimi dhe nxehja
- Cilat janë vështirësitë në të nxënë?
- Si të dallojmë dhe të mbështesim vështirësitë e të nxënit në klasë?

### Nxemja

Reflektoni dhe diskutoni në grupe prej 4 vetash për 15 minuta

- Cilat janë pikat tuaja të forta si mësues/e?
- Cilat janë objektivat e zhvillimit tuaj si mësues/e?




### Vështirësitë në të nxënë

- Mund të jenë zhvillimore (vështirësi të lindura për shkak të ndryshimeve në funksionimin e sistemit nervor qendror), pasojë e sëmundjeve neurologjike, dëmtimeve fizike ose problemeve të shëndetit mendor
- Vështirësitë zhvillimore të të nxënit/mësuarit janë shpesh të trashëguara dhe të përhershme
- Vështirësitë në të nxënë janë të zakonshme, 10-20% e njerëzve kanë vështirësi në të nxënë

## Vështirësitë në të nxënë

- Ndodhin pavarësisht nga aftësitë dhe talentet e tjera të një njeriu
- Vështirësitë në të nxënë mund të mbivendosen me probleme të tjera (ekzistenca e disa sëmundjeve), gjë që e bën identifikimin e tyre më sfidues/më të vështirë
- Ndodhin në mënyra të ndryshme në faza të ndryshme të jetës

## Vështirësitë në të nxënë mund të lidhen me:




## Vështirësitë më të zakonshme në të nxënë

### Vështirësitë më të zakonshme të të nxënit në klasë

- Çrregullime të deficitit të vëmendjes
- Deficite në perceptim
- Disleksia
- Çrregullimet në matematikë
- Dëmtimi i gjuhës zhvillimore (Disfasia)

Çdo nxënës mund të mësojë dhe ka të drejtë të mësojë.  
Çdo nxënës ka aftësitë dhe pikat e veta të forta.  
Si mësues ne duhet të fokusohemi në pikat e forta, përta u  
takon sfidave me të cilat përballemi.



---

## Diskutime

---

### Diskutim për 30 minuta

Diskutoni në grupe prej 3-4 personash

1. Çfarë lloj sfidash të të nxënësve dhe nevojave për mbështetje keni vënë re te nxënësit tuaj?
2. Si e vutë re nevojën për mbështetje?
3. A keni gjetur mënyra për të mbështetur të nxënësve e nxënësit?

Zgjidhni disa mendime për pyetjet 2 dhe 3 që dëshironi t'i ndani me të gjithë grupin.

---

## Si të dallojmë dhe të mbështesim vështirësitë e të nxënësve në klasë?

---

### Si të dallojmë vështirësitë në të nxënësve?

- Mësuesi mund të dallojë vështirësitë në të nxënësve duke vëzhguar performancën dhe sjelljen e nxënësve në klasë dhe në mjedisin shkollor
- Njohja e nxënësve është çelësi për njohjen e vështirësive në të nxënësve

## Pyetje që ndihmojnë në vëzhgimin e performancës dhe sjelljes së nxënësit

- A ka pasur ndonjë ndryshim në sjelljen dhe/ose performancën e nxënësit?
- Si ka ndryshuar sjellja dhe/ose performanca e nxënësit?
- Kur ka ndryshuar sjellja dhe/ose performanca e nxënësit?


## Çfarë duhet të bëni kur vini re se diçka ka ndryshuar në sjelljen ose performancën e nxënësit tuaj?


- Është e rëndësishme që vështirësitë në të nxënë të identifikohen sa më shpejt që të jetë e mundur dhe mbështetja të fillojë në një fazë të hershme
- Si mësues, përpiquni t'u përgjigjeni nevojave të nxënësve sa më shpejt të jetë e mundur dhe të modifikoni mjedisin mësimor dhe shkollor për t'iu përshtatur nevojave për mbështetjen e nxënësve
- Diskutoni me nxënësin, kujdestarët dhe mësuesit e tjerë që i mësim nxënësit, a e kanë vënë re atë që ka ndryshuar tek ai?
- Nëse është e mundur, konsultohuni me profesionistë të arsimit special (mësues për nxënësit me nevoja të veçanta, psikolog shkolle, punonjës social të shkollës, infermiere)

## Si t'i mbështesim nxënësit për të kontrolluar vëmendjen, përqendrimin dhe veprimtarinë

Fokusohuni në:

- Udhëzime
- Strukturë
- Regjim / Rregulla
- Divizione
- Mjete





**Reflektoni:****Çfarë ju thotë nxënësi? Si mund të reagoni ju si mësues/e?**

*Më ndihmo të përqendrohem!*

*Prit, truri im është ende duke menduar*

Krijo një mjedis të qartë për mua ku regjimi/ rregullat më mbështesin.

Më lejoni të funksionoj sipas programit tim. Kur nervozohem, unë mërzitem dhe manifestoj zemërim.

*Ndihem i/e bllokuar dhe nuk përballoj dot detyrat e mia*

Më ndihmo të gjej metoda të ndryshme për zgjidhjen e problemeve. Më duhen opsione për të zgjidhur situata të ndryshme.

*A e zgjidha saktë detyrën? Dua ta di menjëherë*


Më bëni shumë vlerësime/komente të menjëhershme kur të kem sukses me detyrat e mia.

Unë nuk harroj, veshët e mi thjesht nuk mund të dëgjojnë të gjitha udhëzimet



Më jepni udhëzime një nga një dhe sigurohuni që e kam kuptuar atë që dëshironi që unë të bëj.

Veprova gabim kur isha i paduruar.




Më kujtoni: ndalo, mendo, vepro!

Ndajini detyrat e mia në pjesë të vogla, të cilat do t'i zgjidh shpejt.



Jam gati!

Më inkurajoni edhe për një sukses të vogël. Shpërblejeni një përpjekje të mirë edhe pse rezultati nuk është perfekt.



Gjithçka që bëj është e gabuar, apo jo?

Pse më qortojnë gjithmonë?



Vini re veprimet e mia të mira dhe sjelljet pozitive. Në ditën time të keqe, më kujtoni mua dhe vetes tuaj çdo të mirë që kam unë.

## Si të mbështesim perceptimin e nxënësit?


- Mjedis i larmishëm, stimulus dhe i sigurt
